


AKTIVITETI I BASHKIVE NDAJ COVID-19

Periudha 15 Mars-26 Prill




- Vendimarrje online**
60 Këshilla
- Praktika të replikuara**
40
- 60**
Kryetarë/Sekretarë këshillash të trajnuar mbi aspekte të vendimarrjes online

TRE PRAKTIKAT MË TË REPLIKUARA

i Vendimarrje online

Vendimarrja online ka qënë praktika më e shumëfishuar nga këshillat bashkiak. Nga 7 mbledhje në distancë në javën e parë të emergjencës, mbetet vetëm 1 këshill pa e zhvilluar në distancë këtë mbledhje.

Periudha 15 Mars-26 Prill



i Shenjzimi & Tregjet

Masat e sigurisë në vendet e tregëtimit kanë janë vënë në zbatim e shpejtësi të madhe nga bashkitë ku javën e tretë numëroheshin 25 bashki dhe javën e pestë 44 bashki që e shumëfishuan këtë praktikë

i Vullnetarizëm

Bashkitë u mobilizuan ndjeshëm javën e dytë të emergjencës duke ngritur ekipe vullnetarësh si dhe grumbulluar ndihma për familjet në nevojë. 21 bashki e shumëfishuan këtë praktikë në javën e dytë.

COVID 19 - RAPORT PËE 21 - 27 PRILL

RAPORT

**PËR NJË QEVERISJE FUNKSIONALE
NË PËRGGJIGJE TË SFIDËS COVID 19
NË BASHKËPUNIM
ME KOMUNITETET VENDORE**

21-27 PRILL



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ajencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS
ALBANIA



BASHKI të FORTA

PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL

[Kliko këtu](#)

QEVERISJE DEMOKRATIKE

Veprimtaria e Këshillit	Transparencë	Veprimtari te tjera
<p>Vendimarrja: Në javën e gjashtë të emergjencës këshillat bashkiakë paraqiten në një situatë të favorshme për të zhvilluar aktivitetin e tyre vendimmarrës. 60 prej tyre kanë zhvilluar të paktën një mbledhje online, ku 42 këshilla e kanë bërë këtë nëpërmjet platformave me video konferencë. 39 e këtyre këshillave janë asistuar ngushtësisht nga ana teknike prej Bashki të Forta. Këshillat bashkiakë nëpërmjet platformave online kanë miratuar 18 Rregullore të Funksionimit të këshillit, 31 Kode të Sjelljes dhe Etikës, 29 Rregullore për marrëdhënien me publikun si dhe 1 Rregullore të Peticioneve dhe 1 të Strukturave komunitare. Këtë javë u zhvillua një mbledhje në sallën e teatrit të qytetit në Korçë duke ruajtur distancën sociale. Vihet re një dëshirë e shprehur për zhvillimin e mbledhjeve në salla të mëdha edhe në disa bashki të tjera.</p> <p>Mbikqyrja: Nisma për ushtrimin e funksionit mbikqyrës të këshillit janë ndërmarë në një numër këshillash në këtë periudhë. Në 6 bashki¹ ekzekutivi raporton tek këshilli mbi procesin e shpërndarjes së ndihmës dhe jep detaje mbi listën e përfutuesve. Ndërsa 13 prej tyre mbikqyrin grupet e patronazhit për pensionistët e vetmuar. Organizata të shoqërisë civile kanë raportuar rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje që kërkojnë trajtim/këshillim, ndërsa numri i rasteve të raportuara në polici ka rënë. Nisur nga këto konstatime Komisionet e Barazisë Gjinore dhe Barazisë Sociale në Këshilla Bashkiakë² të lehtësuar nga BtF kanë miratuar një rezolutë, e cila mobilizon strukturat bashkiake në monitorimin, parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Këshilli nëpërmjet kësaj rezolute kërkon raportim nga ana e ekzekutivit tek "komisioni i barazisë gjinore dhe mbrojtjes sociale" të rasteve të ndjekura. 9 këshilla bashkiakë e kanë miratuar këtë rezolutë dhe 2 të tjerë e kanë vënë në rendin e ditës në mbledhjen e rradhës. Rezultatet e para të rezolutës janë vënia në dispozicion e banesave sociale (Kuçovë dhe Vlorë) dhe mobilizimi i Policisë për ndjekjen e rasteve (Vlorë).</p>	<p>Transparenca: Në funksion të transparencës dhe ndërveprimit me qytetarët, janë tre këshillat bashkiak (Shkodra, Fieri dhe Kukësi) që kanë zhvilluar mbledhjen e këshillit online duke e transmetuar atë live në Facebook dhe media lokale. Ndërsa në Lezhë dhe Mirditë mbledhjet e mbajtuara nëpërmjet video konferencës janë postuar të plota në faqet e FACEBOOK. Bashkitë informojnë qytetarët nëpërmjet hapësirës elektronike mbi masat shtrënguese apo për kuadrin ligjor të situatës emergjente. Raportim i punës së zhvilluar nga të gjitha strukturat e bashkisë ofrohen në faqen e facebook-ut dhe medias lokale në 21 Bashki³. Në Kukës kryetari i bashkisë zhvillon një konferencë javore të transmetuar në tv lokale për informim të publikut.</p> <p>Aspekte Financiare: Këshillat bashkiakë kanë vepruar në funksion të lehtësimit të barrës fiskale për bizneset vendore duke ulur taksat dhe tarifatat për një sërë aktivitetesh dhe shtyrë afatet për të tjera. Bashkitë Fier, Vlorë, Sarandë, Himarë, Kavajë, Korçë, Përmet, Gjirokastrë i shtohen kësaj jave bashkive Berat, Durrës, Kolonjë, Kukës Lezhë Pogradec, që i morën këto masa në javët e mëparshme. Në Berat falet qiraja e periudhës Prill-Maj për 146 tregtarë të Tregut Industrial me një kosto buxheti 2.565.000 LEK. Ndërsa në Kuçovë falet qiraja e tregut për të gjithë zgjatjen e pandemisë. Këtë javë u vu re dhe reduktimi i taksave të bizneseve që ofrojnë shërbim turistik, si hoteleria (-30% detyrimeve bashkiake për taksën e pastrimit). Gjithashtu 5 bashki janë duke aplikuar zerim apo shtyrje të detyrimeve për banesa sociale.</p> <p>Covid 19 pritet të afektojë edhe të ardhurat vendore. Ndërkohë që bashkitë raportojnë ulje të ndjeshme të grumbullimit të të ardhurave, taksa si ajo mbi biznesin e vogël, ajo e veprimeve hoteliere dhe ajo e tatimit mbi të ardhurat personale, dhe tarifa të tilla si ajo për zënien e hapësirave publike, shërbime veterinarë, gjuetinë, parkimin e automjeteve dhe lëshimin e vërtetimeve, pritet të ulen edhe në ditët në vijim. Kjo rënie dhe rialokimet e bëra gjatë këtyre muajve mund të kërkojnë rishikimin e planeve buxhetore vendore për 6 mujorin e dytë.</p>	<p>Asistencë Teknike: Bashki të Forta ka ofruar asistencë teknike për 35 këshilla bashkiakë nëpërmjet trajnimeve ditore online (kliko këtu) për kryetar dhe sekretar të këshillave bashkiak (60 pjesmarrës). Fokus i trajnimit, "Rregullorja e funksionimit të këshillit", "Rregullorja e Konsultimeve me Komunitetin", "Hartimi i Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak dhe Buxhetimit". Agjencia për Mbështetjen e Pushtetit Vendor ka adresuar këshillat bashkiakë për të nxitur aprovimin e rregulloreve. Këshilli I Bashkisë Roskovec, shënon hapjen e regjistrit elektronik për konsultimet publike dhe duke bërë njoftimet sipas rregullores së re.</p> <p>Organizimi dhe burimet njerëzore: Ekipet e bashkive kanë punuar me orare të zgjatura për të mundësuar shërbime shtesë për komunitetin, ndërsa për një pjesë tjetër janë aplikuar orare të reduktuara dhe rotacion në paraqitjen fizike në punë, të cilat këtë javë janë shtuar.</p> <p>Përveç vullnetarizmit anëtarët e këshillave bashkiakë dhe ekipeve të bashkive kanë dhuruar ndihma për njerëzit më në nevojë. Javën e shkuar, 300 familje u mbështetën me pako ushqimore nga dhurimi i honorareve që anëtarët e Këshilli Bashkiak Shkodër bënë për ato familje që janë prekur më shumë nga situata e krijuar nga COVID-19.</p>

¹ Pogradec, Kolonjë, Devoll, Shijak, Korçë, Kukës

² Polican, Kuçovë, Krujë, Shijak, Patos, Peqin, Has, Kukës, Delvinë

³ Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Vau i Dejës, Shkodër, Durrës, Shijak, Krujë, Devoll, Pogradec, Pustec, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Gramsh, Patos, Tropojë, Krujë, Pogradec, Fier

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE

Dhomat e tregtisë dhe Biznesit

Biznesi: Shoqata e Bisneseve në Rajonin e Kukësit adreson çështje të natyrës fiskale në lidhje me shtyrjen e pagimit të taksave vendore si dhe propozon ndryshime për masat e sigurisë. Në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të biznesit kërkohet kufizim i mënyrës dhe shpeshësisë së lëvizjes, jo i orarit. Mbjatje e detyrueshme e maskave në ambiente publike. Test temperature i detyrueshëm dhe periodik për çdo institucion dhe ndërmarrje në fillim dhe mbarim të punës krahas masave që duhet të zbatohet biznesi.

Komunikim i Dhomës së Tregtisë Vlorë me kryetarin e bashkisë për krijimin e një pakete lehtësuese për biznesin e turizmit. Ka filluar puna për të vlerësuar uljen dhe shtyrje e afateve për pagesën e taksave dhe tarifave për operatorët turistikë.

Bashkëpunim tre palësh dhe Shoqëria civile

Karantinimi: Bashkitë po bashkëpunojnë duke ofruar shërbim për shtetasit e vendosur në karantinë pas riatdhesimit. Një numër bashkish në qarkun e Korçës po asistojnë prefektin dhe policinë e shtetit për zbatimin e urdhërit të karantinimit 14 ditor të emigrantëve të mbërritur nga pikat kufitare pranë në territorit të bashkisë. Shërbimi konsiston në monitorimin nga ana e policisë bashkiake dhe plotësimit për nevoja ushqimore apo për barna gjatë qëndrimit, kjo, me anë të grupeve të patronazhimit.

Zbatimi i rregullave të sigurisë: Në qarkun e Vlorës kanë filluar inspektime të përbashkëta mes prefekturës, bashkisë dhe Institutit të Shëndetit Publik për zbatimin e masave të marra për sigurinë në tregje. Inspektime më të shpeshta nëpër tregjet e qyteteve po zhvillohen në bashki qendër qarku ku dendësia e konsumatorëve është më e lartë.

Pas testimit të formularit online të përgatitur nga Ministria e Brendshme për regjistrimin e shpërndarjes së pakove ushqimore dhe asistencës për të moshuarit, ka filluar zbatimi në terren i raportimit nga tre bashki (Korçë, Patos, Lezhë).

Shoqëria Civile: Shoqëria civile ka rifilluar të zhvillojë aktivitetet në bashki të ndryshme nëpërmjet internetit. Në Roskovec javën që lamë pas u zhvilluar një trajnim online për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës në familje si dhe trajnimi online në kuadër të projektit "Për një pjesëmarrje reale të të rinjve në vendim-marrjen lokale (Ura Vajgurore, Roskovec)

Disifektimi (Ilogaritja e kosto tarifës)

Dizifektimi: Ministria e Turizimit dhe Mjedisit ka dërguar këtë javë në formë zyrtare tek të gjithë bashkitë modelin e Ilogaritjes së kostove të dezinfektimit të ambienteve dhe hapësirave publike, së bashku me rekomandimet përkatëse për aplikimin e tij. Modeli u vjen në ndihmë bashkive duke lehtësuar përlllogaritjen e kostove për ofrimin e shërbimit në mënyrë të shpejtë, efektive dhe transparente në menaxhimin e fondeve. Bashkitë Shkodër, Gramsh, Kurbin dhe Lezhë kanë ndihmuar që me eksperiencën dhe ekspertizën e tyre ta bëjnë këtë model sa më të plotë dhe të aplikueshëm.

BtF dhe GiZ po mbështesin bashkitë partnere për zbatimin e tij duke siguruar nga njëra anë optimizim të fondeve, nga ana tjetër transparencë për publikun dhe vendim-marrje të informuar për Këshillin.

Puna për dizinfektimin e mjedisve dhe ndërtesave publike vijon në mënyrë sistematike, ndërsa në bashki si Tirana është vërejtur koordinim me administratorët e pallateve për të keshilluar dhe nxitur shtrirjen më të gjërë të këtij shërbimi.

PËRMBUSHJA E FUNKSIONEVE VENDORE

Turizmi dhe shërbime publike	Ndihmë psikosociale	Asistencë për emigrantët dhe fermerët
<p>Turizmi: Bashkia Kolonjë është vënë në kontakt me bizneset lokale të agroturizmit që ushtrojnë shërbime turistike, kryesisht bujtina të vogla për sezonin turistik dhe është në diskutim mbi adresimin e rezervimeve të kryera dhe mënyrën se si do të vijohet me sezonin turistik. Vlerësohet se turizmi malor falë natyrës së shërbimit ka potencial për t'u përshtatur më mirë me rregullat e distancimit social. Puna përgatitore në këtë drejtim ka nisur në bashkitë malore si Puka dhe Tropoja.</p> <p>Bashkitë, të ardhurat e të cilave varen nga turizmi detar po konsiderojnë hartimin e masave dhe planeve konkrete për sezonin e ri turistik i cili pritet të jetë i orientuar nga pushuesi vendas. Në pritje të udhëzimeve nga Ministria e Turizmit për qasjen që do ndiqet këtë sezon bashkitë po konsiderojnë një seri masash lehtësuese të natyrës fiskale (zbritje taksash dhe tarifash) si dhe masa për sigurinë e plazhistëve (hapësira midis çadrave, zhvendosje në distance e tregëtarëve ambulantë, shenjzim i parkimeve të makinave dhe mjeteve lundruese etj) dhe bizneseve që ofrojnë shërbim.</p> <p>Distanca Sociale: Pas tregjeve dhe bizneseve, shenjzim për të ruajtur distancën sociale po aplikohet dhe për hapësirat ku institucionet publike ofrojnë shërbim.</p> <p>Ndërkohë që emergjenca shëndetësore ka marrë të gjithë vëmendjen, zyrat e emergjencave prane bashkive rurale po përballen edhe me shuarjen e zjarreve sporadike në pyje. Fushë Arrësi i shtohet bashkive të tjera si Lezha, Mirdita, Klos, Mat që kanë pasur raste të tilla.</p>	<p>Dhuna në familje dhe ndihmë psikosociale: Intensifikim nga ana e bashkive në raport me masat për informim dhe parandalim të dhunës në familje. 14 bashki⁴ kanë vënë në dispozicion numrat e punonjësve socialë për denoncim të rasteve të dhunës në familje. Në Lezhë ofrohet një aplikacion në funksion të këtij shërbimi. Po në këtë bashki shërbimi social në partneritet me Eorld Vision ka nisur një program social që ofron shërbime në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara, në zona të thella të bashkisë. Në bashki si Dibra dhe Kukësi ofrohet terapi dhe këshillim me telefon apo duke zhvilluar vizita nga profesionistët në kushtet e qëndërimit në shtëpi. Ndërsa në bashki më të mëdha këshillimi në distance ofrohet me telefon ose online si në rastin e (Shkodrës dhe Elbasanit)</p> <p>Me iniciativën e BtF, 10 bashki kanë firmosur marrëveshje për bashkëpunuar me ZVAP-et për ofrimin e shërbimit psiko-social për fëmijët 3-6 vjeç, bazuar në praktikën e mirë të bashkisë Durrës. Deri tani falë këtij mobilizimi janë trajtuar 10 raste në bashkitë Durrës dhe Kukës. Ndërkohë që Drejtoria Rajonale e Arsimit Lezhë ka udhëzuar zyrat vendore që të asistojnë me shërbim psikologu edhe fëmijët 3-6 vjeç në koordinim me bashkitë.</p>	<p>Emigrantët e Rikthyer: Bashkive kanë lehtësuar kostot e karantinimit të emigrantëve të rikthyer duke ofruar ushqim falas (Pogradec, Korçë dhe Gjirokaësë) apo kanë përshtatur ndërtesa publike si konvikte shkollash (Libohovë, Saranda, Shkodra) për strehimin e tyre duke mënjanuar kostot e larta të hotelierisë. Bashkitë bashkëpunojnë me biznesin apo OJF për të siguruar dhe dorëzuar ushqimin e ofruar.</p> <p>Ndihmë për fermerët: Grupet e patronazhit në secilën njësi administrative të Kolonjës kanë mundësuar transportin e plehërave, farërave si edhe ushqimin e bagëtive sipas kërkesave të banorëve fermerë, për të mos penguar aktivitetin e tyre edhe në njësitë më të largëta. Transporti është realizuar me ndihmën e Drejtorisë së Shërbimeve në bashki (Kolonjë).</p>

⁴ Dibër, Klos, Malesi e Madhe, Fushe Arrëz, Shijak, Lushnjë, Selenicë, Himarë, Pogradec, Lezhë, Durrës, Gramsh, Mirditë, Has